



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III-

Nr. i prot.
Br. prot.

181


Më

Dt. 20.01.2022

RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORTI VJETOR I PUNËS

JANAR-DHJETOR 2021



2021

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike, në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Planit të Punës për vitin 2021, përkundër sfidave dhe vështirësive ka përfunduar me sukses një sërë projektesh dhe ka realizuar një mori aktiviteteve përgjatë kësaj periudhe raportuese. Në vazhdim DSHP ka raportuar mbi thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

- Gjatë kësaj periudhe komuna e Rahovecit, respektivisht DSHP ka qenë e angazhuar gjatë tërë kohës me intervenime emergjente në disa prej vendbanimeve të komunës sonë, ku ka pasur aktivitete në deblokimin e kanalizimeve, rregullimin e disa rrugëve, dy segmente në Gur të Kuq, një segment në Polluzhë, një segment në Potoqan si dhe pastrimin e përroskave në Celinë, Brestoc, Malësi e Vogë, Cifllak dhe në shumë pozicione të tjera;
- Gjatë kësaj periudhe ka përfunduar projekti i zgjerimit të rrjetit të ujërave fekale dhe atmosferike, në Celinë, Dejnë, Malësi e Vogël, dhe Rahovec;
- Kompania për mbledhjen e mbeturinave KRM Ekoregjioni njësisë në Rahovec në muajin mars ka bërë shtrirjen edhe në 3 vendbanime, Fortesë, Xërxë dhe Zatriq, kërkesë kjo e donatorëve që ka komuna e Rahovecit;
- Gjatë kësaj periudhe ka pasur aktivitete në mjedis, është bërë edhe krasitja dhe mirëmbajtja e drunjëve dekorativ sipas kontratave ekzistuese me operator ekonomik;
- Kanë përfunduar punimet në qytet në rrugën Ali Hasku, janë tejkaluar problemet pronësore, në vendosjen e rrjetit nëntokësor të ujërave fekale, atmosferike dhe rrjetit të ri të ujësjellësit;
- Kanë vazhduar punimet në rrugën 4 korsi, Lot 3, nga rrethrotullimi i hyrjes së qytetit;

Aktivitetet në periudhën: prill, maj, qershor

- Kanë përfunduar projektet e ndriçimit publik në 25 vendbanime të komunës sonë, si dhe në lagjet urbane me gjatësi 75 km ndriçim publik;
- Gjatë vitit 2021 kanë përfunduar me kubëzim dhe asfaltim gjithsej 60 km rrugë;
- Me zgjerimin e rrjetit të kanalizimit të ujërave fekale dhe atmosferike kanë përfunduar 22 km kanalizim, poashtu janë furnizuar 8 km gypa nga PVC, në bazë të kërkesave të qytetarëve;
- Trotuarë gjatë vitit 2021, janë kontraktuar 13.7 km në 14 vendbanime dhe në Qytetin e Rahovecit, janë përfunduar 15 km trotuar, projekti do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm;
- Gjatë vitit 2021 nga Granti i Performancës Komunale janë kontraktuar nga komuna e Rahovecit 24 km rrugë lokale;
- Ka përfunduar projekti për ndërtimin e rrugës Rahovec – Hamoc – Fortesë;
- Ka përfunduar projekti për ndërtimin e rrugës Xërxë – Sapniq – Ratkoc;
- Ka përfunduar projekti për instalimin e tërësishëm të kamerave të sigurisë në Qytet dhe në Xërxë, projekt i mbështetur nga donatorët;
- Ka përfunduar asfaltimi i segmentit të mbetur Xërxë-Sapniq- Ratkoc, ka mbetur vetëm sinjalizimi

Aktivitetet në periudhën: korrik, gusht, shtator

- Gjatë tërë vitit 2021 janë larguar gjithsej 55 deponi ilegale të mbeturinave;

- Jemi marrur me aktivitete mjedisore, në Rahovec, janë punuar dekorimet në 3 hyrjet dhe daljet e qytetit në rreth-rrotullime, në disa hapësira tjera janë mbjellur gjelbërim si dhe pastrime në shumë pozicione;
- Është lëshuar në përdorim uji i pijshëm për fshatin Patasel;
- Ka përfunduar projekti për ndërtimin e kanalit atmosferik në Qytet;
- Ka filluar ndërtimi i dy segmenteve rrugore në fshatin Drenoc, punimet janë duke vazhduar;
- Jemi përfitues të grantit nga ana e GIZ-it për kontejnerë të rinjë, për komunën tonë, vlera e grantit është mbi 106,000.00 euro;
- Janë ndërtuar në dy kryqëzime semaforët e rinjë;
- Kemi zhvilluar procedurën për komisionin e ankandeve pas ligjshmërisë nga ana e MAPL-se dhe MEA, për deponinë legale të mbeturinave;
- Kanë përfunduar punimet në Celinë, në rregullimin e rrugës pas vendosjes së kanalit atmosferik;
- Kanë përfunduar punimet në mure mbrojtëse në dy lagje në Rahovec;

Aktivitetet në periudhën: tetor, nëntor, dhjetor

- Gjatë kësaj periudhe kanë filluar punimet në ndërtimin e rrugëve lokale faza e dytë, në fshatin Drenoc, Rahovec, Guri i Kuq dhe Retijë e Ulët;
- Me projektin e ri të rrugëve lokale kemi filluar punimet në lagjen e komuniteteve;
- Në drejtorinë e shërbimeve publike janë adresuar 460 kërkesa në infrastrukturë publike ku: 360 janë të miratuara, 85 janë të refuzuara, 2 janë pezulluar, 1 është anuluar, 11 janë në proces të zgjidhjes dhe një e pranuar.

Sfidat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vitin 2022 janë:

- Sfidat e drejtorisë do të jenë mundësitë buxhetore që kemi si drejtori, kemi shumë kërkesa të ndërtimit të rrugëve lokale të rrugëve dytësore dhe të pa kategorizuara, ka me qindra kërkesa që po adresohen në drejtori;
- Mirëmbajtja e përrunjve dhe kanaleve që gjenden në vendbanime dhe në lagjet urbane;
- Kërkesa të vazhdueshme për ndriçim publik; për ndërtim të trotuareve; mbeturinat e amvisërisë që fatkeqësisht hidhen kudo, vend e pa vend ku krijohen deponitë ilegale;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë të shtrirë rrjetin e KRU Gjakovës si dhe kërkesat e shumëta për zavendsimin e gypave të rinjë të azbestit.

Drejtori i DSHP-së

Përparim Krasniqi